



Buletini

- * Hyrje
- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
- * Aktivitetet tjera

Qershor 2020

Hyrje

Edhe gjatë muajit qershor, si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 Akademia e Drejtësisë ka vazhduar veprimtarinë e saj duke i ri dizajnuar aktivitetet trajnuese si në trajnimet e vazhdueshme ashtu edhe në ato fillestare si dhe aktivitetet tjera në përputhje me këto rrethana. Bazuar në vendimin e qeverisë e duke respektuar distancën dhe masat tjera trajnimet janë realizuar përmes platformës ZOOM ndërkaq takimet dhe aktivitetet tjera janë realizuar edhe fizikisht por në grupe të vogla dhe duke i respektuar masat parandaluese.

Për më tepër në këtë buletin në rubrikat në vijim pasqyrohen aktivitetet e përgjithshme në dobi të zbatimit të programeve trajnuese, aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të vazhdueshme të specifikuara sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj, aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare sipas sesioneve dhe moduleve trajnuese si dhe aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime.

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi me Projekte të Donatoreve

Gjatë muajit qershor, në vazhden e bashkëpunimit me miqtë dhe partneret e AD-së janë realizuar takime virtuale por edhe fizike për të konkretizuar aktivitetet e asistencës në zhvillim dhe zbatim të programeve trajnuese.

Në kuadër të bashkëpunimit me përfaqësuesit e zyrës OPDAT të Ambasadës së SHBA-ve është vazhduar në iniciativën e përbashkët me AD në analizën e kapaciteteve të AD nëpërmes metodologjisë SWOT. Qëllimi i kësaj analize është të ndihmojë AD në identifikimin e nevojave, vlerësimit dhe përmirësimit të metodologjisë së vlerësimit të nevojave për trajnim, si dhe vlerësimin e strukturës së programeve të trajnimit. Përveç kësaj ka vazhduar mbështetja edhe në sferën e trajnimeve me theks të veçantë realizimi i trajnimit me temë: “Program i Specializuar Trajnimi-Prokurimi publik - Sesioni I”.

Bashkëpunimi me projektin e BE-së Mbështetje e Kodit Civil Faza 2, ka vazhduar , edhe më tej i cili rezultoj me realizimin e trajnimit me temë: “Burimet se së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimit së personave fizik dhe juridik si dhe punët juridike”

Nga projekti i USAID-it për Drejtësi Komerciale (CJA) AD ka pranuar një koncept dokument për bashkëpunim në zbatimin e trajnimeve në fushën e te drejtës komerciale për gjyqtarët.

Bashkëpunimi me organizatën INJECT Kosova, ka vazhduar dhe AD ka pranuar video-trajnime në fushën e “Dhunës në familje”, të përgatitura për t’u lansuar në platformën E learning.

Me kërkesë të zyrës së KE në Prishtinë, AD së bashku me kryesuesin e KGJK-së, Kryetarin e Gjykatës Supreme, Gjyqtarin nga Gjykata e Apelit, Kryetaren e GJTH në Prishtinë dhe Kryetarin e GJTH të Ferizajt, ka marrë pjesë në takimin virtual të mbajtur me anëtarët e Komisionit të Venecias ku janë diskutuar komentet në lidhje me nstitutin e “gjykimit në mungesë”

Bashkëpunimi me projektin KOSEJ te KE ka vazhduar edhe gjate këtij muaji. Në takimin virtual ndërmjet përfaqësuesve të projektit KOSEJ dhe AD është diskutuar nevoja për një takim të përbashkët me krerët e KGJK-së dhe KPK-së në lidhje me zhvillimin e kurikules trajnuese për indikatorët dhe metodologjinë raportuese të CEPEJ-it.

Në vazhden e bashkëpunimit me projektin e GIZ/LARP është diskutuar përfshirja e aktivitete të përbashkëta në kalendarin trajnues të PTV-së për periudhën shtator-dhjetor 2020. Po ashtu në takim është diskutuar edhe për aktivitetet që do të kenë numër më të madhë të aplikuesve serb dhe që do të mbështeten nga GIZ.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Burimet se së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimit të personave fizik dhe juridik si dhe punët juridike

Më 02 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e BE-së - “Mbështetje Kodit Civil Faza 2”, organizoj trajnimin me temë: “Burimet se së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimit të personave fizik dhe juridik si dhe punët juridike” në kuadër të PTV-së. Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom direkt/live nga ora 13:00-16:00.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi i pjesëmarrësve lidhur me risitë e Draft Kodit Civil, me theks të veçantë dallimin nga rregullimi aktual ku burimet e së drejtës trajtohen kryesisht vetëm në rrafshin teorik, ndërsa me draftin e Kodit Civil janë paraparë shprehimisht burimet e së drejtës.

Gjatë këtij trajnimi u prezantuan temat: Burimet se së drejtës, analogjia dhe interpretimi i zotësisë juridike dhe zotësisë së veprimit të personave fizik dhe juridik; Përkufizimi dhe llojet e punëve juridike vlefshmëria-pavlefshmëria e tyre, Shqyrtimi i rasteve të anulimit relativ dhe absolut të punëve juridike.


Gjatë trajnimit janë elaboruar edhe pasojat e pavlefshmërisë së punëve juridike, si dhe dallimet në mes të pavlefshmërisë absolute dhe relative, po ashtu u diskutua a duhet gjykata të refuzoj kërkesëpadinë kur puna juridike që kërkohet të anulohet është absolutisht nule, apo duhet që të lëshoj aktgjykim të karakterit

deklarativ ku konstaton pavlefshmërinë absolute?

Në trajnim u zbërthyen çështjet lidhur me gjetjen e burimeve të së drejtës për zgjedhjen e rasteve konkrete, gjetjen e ngjashmërive në rastet kur zgjidhja mund të arrihet përmes analogjisë në mungesë të dispozitave specifike si dhe ngritjen e aftësive në të kuptuarit e rëndësisë së aftësisë juridike dhe të veprimit.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, paraqitja e këndvështrimeve të pjesëmarrësve, prezantimi përmes PowerPoint, pyetje-përgjigjet dhe analizimi i rasteve nga praktika.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar nga niveli themelor (divizioni Civil) nga të gjitha regjionet, bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor.



Masat e Diverzitetit

Më 3 dhe 4 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin, me temë “Masat e Diverzitetit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë në praktikë i masave të diversitetit.


Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtuan kushtet për shqiptim të masave të diversitetit, vlerësimin të masave adekuate për situatat specifike dhe identifikimi se ndaj kujt dhe për çfarë vepra mund të shqiptohen këto masa. Gjatë këtij sesioni u trajtuan legjislacioni vendor, me theks të veçantë Kodi i Drejtësisë për të Mitur, ku u theksuan mangësitë dhe problemet në zbatimin praktik të masave të diverzitetit posaçërisht të masave të

reja të cilat kane hyrë në fuqi.

Në këtë kontekst u diskutua pëlqimi i të miturit për shqiptim të masës së diversitetit, prezenca e të miturit, prindit dhe mbrojtësit në seancë për shqiptim të masës së diversitetit, marrja e aktvendimit për shqiptim e masave të diversitetit.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Gjyqtarët nga Gjykata e Apeli, gjyqtarë dhe prokurorë për të mitur nga regjionet e Kosovës.



E drejta për liri dhe siguri-neni 5 i KEDNJ


Më 10-11 Qershor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “E drejta për liri dhe siguri-neni 5 i KEDNJ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira në zbatimin e drejtë të Konventës Evropiane dhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtua, neni 5 i KEDNJ-së-E drejta për liri dhe siguri personale e cila paraqet rëndësi shumë të madhe në një shoqëri demokratike. Andaj, në përputhje me parimet bazë të këtij neni GJEDNJ është e mendimit se arrestimi, ndalimi, paraburgimi i një individi në kundërshtim me këtë nen përbën një mohim të plotë të garancive themelore të përcaktuara nga

Konventa dhe një shkelje tejet të rëndë të kësaj dispozite. Gjatë trajnimit u theksa se në rast heqjeje lirie, është me rëndësi veçanërisht të madhe që të përmbushet parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike. Për pasojë, është thelbësore që kushtet e heqjes së lirisë në bazë të së drejtës së brendshme të jenë të përcaktuara qartësisht dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që të plotësohet kriteri i ligjshmërisë, gjë që Kodi i Procedurës Penale ka rregulluar këtë çështje në mënyrë perfekte.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve si dhe përmes vendimeve dhe rasteve praktike të GJEDNJ-së Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtar dhe prokurorë nga niveli themelor dhe Bashkëpunëtor profesional.



Procedura gjyqësore në rastet e shpronësimit

Më 15-16 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë në përkrahjen e GIZ-it organizoj trajnimin me temë: “Procedura gjyqësore në rastet e shpronësimit” në kuadër të PTV-së. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, përmes platformës Zoom. Dita I me 15.06.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 16.06.2020 nga ora 13:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve në zbatimin e drejtë të procedurës gjyqësore në rastet e shpronësimit. Në dy ditët trajnimit u trajtuan temat në vijim: Kushtet ligjore për shpronësim; Procedura e shpronësimit në rastet kur organ shpronësues është Qeveria apo Komuna; Vendimi preliminar dhe përfundimtar për shpronësim, mjetet juridike dhe Mënyra dhe kriteret për caktimin e kompensimit në rastet e shpronësimit.

Në trajnim u trajtua shpronësimi i pronës së paluajtshme i cili në mënyrë specifike është i rregulluar me Ligjin nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme i shpallur më 23.04. 2009, i cili Ligj ka ç’ fuqizuar Ligjin për Eksproprijimin e vitit 1979 (GZ e KSAK 21/78). Me këtë Ligj janë përcaktuar rregullat dhe kushtet në bazë të të cilave Qeveria ose komunat mund të bëjnë shpronësimin e të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi, respektivisht mund të bëhet kufizimi i disa të drejtave dhe shfrytëzimi i përkohshëm i pronës së paluajtshme.

Në vazhdim u theksua se me këtë Ligj përcaktohen kushtet dhe rregullat sipas të cilave rregullohet procedura për shpronësimin e pronës së paluajtshme, kufizimit të pronësisë, procedura e caktimit të lartësisë së kompensimit për patundshmërinë e shpronësuar para organit shpronësues dhe ankesat mbi shumën e


kompensimit para Gjykatës. U shpjegua edhe situata e caktimit të kompensimit për paligjshmërinë e eksproprijuar, kur pronari i mëparshëm apo zotëruesit e interesit në pronë, është i pa kënaqur me shumën e kompensimit të caktuar në vendim përfundimtar.

Gjithashtu u potencua se instituti juridik i shpronësimit lejon mundësinë që pronari të mund të zhvishet nga e drejta e pronësisë vetëm nën kushtet e parapara me ligj me kusht që shpronësimi të bëhet për qëllim të interesit të përgjithshëm.

Në trajnim u zbërthyen edhe raste nga praktika gjyqësore nga GJEDNJ në Strasburg në tematikën e shpronësimit. Pastaj u elaboruan përvojat dhe praktiket e mira të shteteve në rajon në rastet e shpronësimit dhe në praktikën gjyqësore vendore duke zbërthyer dhe analizuar procedurën e shpronësimit, dhe duke identifikuar kushtet paraprake dhe kriteret të cilat zbatohen për shpronësim.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin: Gjyqtarë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit si dhe Gjyqtarë nga niveli themelor.



Program i Specializuar Trajnimi-Prokurimi publik Sesioni I

Më 17-18 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV) në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të SHBA-së/OPDAT realizuan trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Program i Specializuar Trajnimi-Prokurimi publik - Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi është avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me prokurimin publik dhe zbatimin e drejtë të dispozitave lidhur me hetimin dhe gjykimin e veprave penale të kësaj natyre.


Në fokus të këtij trajnimi ishte faza e implementimit të kontratës dhe po ashtu hetimi dhe gjykimi i veprave penale të kësaj natyre.

Gjatë këtij trajnimi veç tjerash janë elaboruar vlerësimi i nevojave duke përfshirë planifikimin e prokurimit, njoftimin indikativ dhe specifikimin teknik. Po ashtu gjatë sesionit

të parë të trajnimit është diskutuar procesi i dizajnit dhe përgatitja e dokumenteve të ofertimit siç janë dosja dhe dorëzimi i tenderit, dorëzimi i dosjes dhe hapja publike. Pjesë e trajnimit ka qenë edhe zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit përfshirë komisionet vlerësuese, kriteret e vlerësimit dhe rekomandimi i operatorit fitues.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, Gjyqtarë nga Gjykata Themelor të të gjitha regjioneve, avokat shtetëror dhe zyrtar ligjor.



Pastrimi i parave me ekspertë të sektorit publik dhe privat të Italisë

Me 17 dhe 18 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë dhe Zyra e UNDP-së në Kosovë përmes Projektit të SAEK II ka facilituar pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në Webinarin mbi Pastrimin e parave me ekspertë të sektorit publik dhe privat të Italisë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ngritja e kapaciteteve profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në hetimin dhe trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave.


Me rastin e këtij aktiviteti nga ora 10:00-12:00, ekspertet nga Banka Qendrore Italiane dhe Guardia di Finanza (Policia Financiare) kane

diskutuar dhe prezantuar përdorimin e analizave strategjike në pastrimin e parave dhe gjurmimin e pronësisë përfituese si dhe ofrimin e njohurive rreth përdorimit të personave juridikë dhe mekanizma tjerë korporativë në juridiksionet e huaja.

Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë 4 gjyqtarë nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe 7 prokurorë të cilët kryesisht ishin nga Prokuroria Themelore në Pejë, Gjakovë, Prizren dhe e Ferizajit.

Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Më 22-23 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Hartimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore” në kuadër të PTV-së. Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 22.06.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 23.06.2020 nga ora 13:00-15:30. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e hartimit dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore.



Në dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Llojet e arsyetimit ligjor dhe parimet e shkrimit të mirë ligjor; Kërkesat ligjore për shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe Zbatimi i metodës IRAC gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore.

Në trajnim u theksua se kualiteti i vendimeve gjyqësore kryesisht varet nga kualiteti i arsyetimit. Më tej u tha se arsyetimi i vendimeve jo vetëm se ju mundëson palëve që lehtësisht ti kuptojnë dhe pranojnë vendimet, por para së gjithash paraqet mbrojtje nga arbitrariteti. Në rend të parë, arsyetimi i obligon gjyqtarët të përgjigjen në pretendimet e palëve, ti paraqesin qëndrimet të cilat justifikojnë vendimin dhe e bëjnë të ligjshëm, i mundësojnë shoqërisë të kuptoj funksionimin e sistemit gjyqësor.

Gjithashtu u potencua se përmes metodës IRAC, ekziston mundësia që problemi të trajtohet në mënyrë logjike, konsistente dhe të plotë. Fillimisht identifikohet çështja gjyqësore ose problemi që adresohet, pastaj shpjegohet norma ligjore (premissa e parë), duke vazhduar

me aplikimin e saj në faktet specifike të situatës së çështjes (premissa sekondare), për të arritur tek konkluzioni me përgjigjen në pyetjen e parashtruar në hapin e parë.

Në vazhdim u trajtuan edhe struktura dhe përmbajtja e vendimeve gjyqësore sipas dispozitave të LPK-së dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore (analizë e konstatimit të fakteve, vlerësimit të provave dhe zbatimit të normës juridike).

Gjithashtu u potencua se shkrimi dhe arsyetimi ligjor është pjesë e punës së përditshme për secilin gjyqtarë dhe zyrtarë të gjykatave dhe prokurorive, prandaj është edhe parakusht për ngritjen e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera, e rrjedhimisht edhe parakusht për efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në vendimet gjyqësore. Shkrimi i mirë ligjor karakterizohet me saktësinë, karakterin analitik, organizimin e mirë, konkretësinë, logjikën, korrektësinë, arsyetimin bindës dhe qartësinë.

Lidhur me aktgjykimin u potencua se gjykata me të vendos për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit. Me rastin e vendosjes për çështjen kryesore gjykata është e lidhur më kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendos për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala. Gjykata me rastin e vendosjes meritorë ka për detyrë që të vendos për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe u ofruan përgjigje në pyetjet dhe paqartësitë e ngritura për të gjitha komponentët e shkrimit dhe arsyetimit të mirë ligjor.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.

Program i Specializuar Trajnimi-Krimi kibernetik, provat elektronike - Sesioni I

Më 24-25 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin e specializuar me temë “Trajnimi-Krimi kibernetik, provat elektronike - Sesioni I”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rreth formave të krimit kibernetik si dhe veprat penale që janë të ndërlidhura me krimin kibernetik.


Në fokus të këtij sesioni trajnues ishin bashkëpunimi ndërkufitar dhe ndërkombëtar në luftën kundër krimit kibernetik, institucionet kompetente që merren me këto vepra dhe veprat tjera që lidhen me krimin kibernetik, mundësitë e ndjekjes së suksesshme të e-krimin ndërkombëtar dhe krimit kibernetik.

Gjatë trajnimit u trajtuan krimi kibernetik dhe sfidat në luftimin e tij, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës së krimit

kibernetik, ndërlidhjen e këtij krimi apo shfrytëzimi i sistemit informativ në kryerjen e veprave tjera të ndërlidhura penale.

Trajnimi u zhvillua përmes diskutimeve interaktive, dhe me trajtimin e rasteve praktike, ku u diskutua rreth sfidave në praktikë dhe vështirësive që gjyqtarët dhe prokurorët hasin gjatë punës së tyre. Gjithashtu në këtë trajnim u përdorën metodat e krahasimit të legjislacionit vendor me atë ndërkombëtarë që e sanksionojnë krimin kibernetik si dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në luftimin e kësaj dukurie.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarët nga gjykata e Apelit, gjyqtare dhe prokuror nga niveli Themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës si dhe avokat nga Avokatura Shtetërore.



Mjetet e Përmbarrimit

Më 29-30 qershor 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me përkrahjen e GIZ-it me temë: “Mjetet e Përmbarrimit” në kuadër të PTV-së. Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 29.06.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 30.06.2020 nga ora 13:00-15:30. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e mjeteve përmbarrimore.

Në dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Llojet e mjeteve përmbarrimore në procedurën përmbarrimore; Kategorizimi i mjeteve të përmbarrimit dhe Procedura gjyqësore përmbarrimore sipas mjeteve të përmbarrimit. Pastaj u zbërthyen edhe çështjet lidhur me përmbarrimin në sendet e luajtshme, veprimet përmbarrimore, seanca e shitjes publike, autorizimi për shitjen e sendit të lënë peng, ankandet, shitja me marrëveshje, paluajtshmeria me shumë pronar, detyrimet e bankave dhe dorëzimi dhe marrja e fëmijës.

Në trajnim u theksua se Ligji për Procedurën Përmbarrimore rregullon procedurën përmes të cilës gjykatat dhe përmbarruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarrimin në baze të dokumenteve përmbarrimore dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe. Në kuptim të këtij ligji cilësinë e organit përmbarrues e ka përmbarruesi privat dhe gjykata e shkallës së parë, gjë kjo e cila nuk ka qenë e paraparë me ligjet e mëhershme të procedurës përmbarrimore. Përmes këtij ligji është synuar që lëndët përmbarrimore për shkak të natyrës së tyre urgjente të mund të trajtohen brenda një afati sa më të shkurtër kohor, gjë e cila drejtpërdrejt do të kishte ndikim pozitiv në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për realizimin me kohë të kërkesave të tyre.


Gjithashtu u potencua se mjetet e përmbarrimit janë metoda me të cilat organi përmbarrues qoftë edhe pa pëlqimin e debitorit, ndërmer veprime për realizimin e kredisë së kreditorit.

Veprimet përmbarrimore kryhen me qëllim të zbatimit të përmbarrimit. Zbatimi i përmbarrimit përbehet nga veprimet që kryejnë organet përmbarruese, si gjykata apo përmbarruesi privat, me qëllim të krijimit të një situatë të re materiale juridike, në mes të palëve në procedurë, apo në mes palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë që fitojnë ndonjë të drejtë në procedurë. Llojet e mjeteve përmbarrimore janë si rezultat i dinamikës së zhvillimit të rrethanave ekonomike, domosdoshmërisë për realizimin më efikas të kërkesës së kreditorit, gjithmonë duke pasur për bazë edhe parimin e mbrojtjes së debitorit, dinjitetin e tij, duke mos cenuar me këto veprime të mirat materiale të domosdoshme për ekzistencë.

Në trajnim u zbërthyen edhe raste nga praktika gjyqësore nga GJEDNJ në Strasburg në tematikën e përmbarrimit. Pastaj u elaboruan praktikat e mira të shteteve në rajon në rastet e përmbarrimit dhe në praktikën gjyqësore vendore duke zbërthyer dhe analizuar procedurën e përmbarrimit dhe etapat e saj.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore (divizioni civil), nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit qershor, prokurorët e sapo emëruar kanë vazhduar me realizimin e trajnimit teorik në formë virtuale përmes platformës online Zoom si dhe trajnimi praktik në prokuroritë përkatëse.

Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar sesionet (10) sesione trajnuese nga moduli: Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare dhe Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të nën modulit: “Etika profesionale” është vazhduar me realizimin e dy (2) sesioneve trajnuese ndër të cilat prokurorët e sapo emëruar kanë përsosur njohuritë e tyre rreth: Bashkëpunimit dhe koordinimit të ndërsjellët mes prokurorit dhe policisë për raste të ndjeshme dhe transparencës, komunikimit, besimit dhe respektit të ndërsjellët si dhe pranimin e përvojave të policisë - udhëzimet ligjore nga prokurori.


Nga nën modulit: “Arsyetimi i vendimeve” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese dhe janë trajtuar: Parimet e shkrimit ligjor, shkrimi ligjor dhe metodologjia e përdorimit të formulës IRAC, arsyetimi i akteve të prokurorit dhe interpretimi i drejtë i normave ligjore dhe arsyetimi.

Trajnimi teorik për muajin qershor është përmbyllë me nën modulin: “Organizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial” me ç’rast, prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku kanë përfituar njohuri të reja rreth: Organizimit të sistemit gjyqësor sipas Ligjit për Gjykatat nga Gjykata Themelore, ajo e Apelit dhe Supremes, baza ligjore e sistemit prokurorial, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe mandati i tij, prokurori i shtetit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Prokuroria e Apelit si dhe detyrat, kompetencat dhe vlerësimi i performancës së prokurorit të shtetit

Gjatë realizimit të trajnimit teorik, prokurorët e sapo emëruar kanë zhvilluar interaktivitetet me trajnuesit duke trajtuar edhe raste nga praktika në punën e tyre në prokurori.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar dymbëdhjetë (12) ditë trajnim praktikë në prokurori.

Trajnimit fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar gjenerata e (VIII).



Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar


Gjatë muajit qershor gjyqtarët kanë vazhduar me realizimin e trajnimit teorik përmes platformës online “Zoom” sipas kalendarit trajnues. Sesionet e mbajtura nga nën moduli “Kodi i Procedurës Penale” dhe nga nën moduli “Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor” kanë shënuar fundin e trajnimit teorik për këtë gjeneratë.

Në kuadër të nën modulit: Kodi i Procedurës Penale janë realizuar (2) sesione trajnuese. Poashtu edhe nga nën modulit “Shqyrtimi fillestar, shqyrtimi i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese, ku gjyqtarët u informuan lidhur me shqyrtimin gjyqësor, shtyrjen ndërprejten dhe

kohën e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, rrjedhen e shqyrtimit gjyqësor, fillimin e shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimin e të akuzuarit. Më tej janë trajtuar edhe marrja, përpilimi me shkrim dhe dorëzimi i aktgjykimit.

Gjyqtarët e sapoemëruar kanë mbajtur testin përfundimtar me datën 15,16,17 qershor, dhe trajnimin praktik e kanë përfunduar me 24 qershor.

Trajnimin fillestar e kanë ndjekur (37) gjyqtarë të sapoemëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.



Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

Takimi i Këshillit të Redaksisë

Më 24 qershor 2020, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës i Këshillit të Redaksisë së revistave të Akademisë së Drejtësisë.



Me rastin e këtij takimi Redaksia diskutoi për punimet hulumtuese të gjyqtarëve të sapo emëruar të gjeneratës së gjashtë dhe prokurorëve të sapo emëruar të gjeneratës së shtatë të PTF-së. Bazuar në vlerësimet e këtyre punimeve dhe rishikimin e tyre nga autorët përkatës pas rekomandimeve dhe vërejtjeve të Redaksisë, u shqyrtua mundësia për publikim në revistën “Justicia” nëse edhe më tutje

përpunohen duke iu përmbajtur rregullave dhe kriterëve për publikim.

Gjatë këtij takimi u prezantuan edhe punimet e gjyqtarëve të sapo emëruar të gjeneratës së shtatë të cilat do të nënshtrohen procesit të vlerësimit nga kjo Redaksi. Përndryshe gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar me Rregulloren e PTF-së kanë për obligim hartimin e punimeve hulumtuese por jo edhe të kenë punim të publikuar. Andaj, nga Redaksia u potencua që do të punojnë vetëm me autorët, punimet e të cilëve kanë vlerë dhe të cilët i përpunojnë punimet e tyre duke respektuar standardet për publikim.

Në takim përveç anëtarëve të Këshillit të Redaksisë morën pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Programit për Hulumtime dhe Publikime i Akademisë së Drejtësisë.



Aktivitetet tjera

Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Më 23 qershor 2020, në Akademinë e Drejtësisë, është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Në këtë takim, Këshilli Drejtues, sipas rendit të ditës fillimisht shqyrtoi dhe miratoi Kërkesën Buxhetore 2021-2023 të Akademisë së Drejtësisë.


Gjatë shqyrtimit të Kërkesës Buxhetore, diskutimet kryesisht u përqendruan në nevojën që të mbështetet kërkesa e Akademisë për rritjen e numrit të stafit të nevojshëm profesional dhe administrativ, për zbatim të programeve trajnuese dhe për menaxhim dhe administrim të shërbimeve të përgjithshme.

Më pas, Këshilli Drejtues, shqyrtoi dhe miratoi Programin e Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e

sapo emëruar 2020-2021, me aprovimin e një rekomandimi të Këshillit Programor. Gjatë diskutimeve, anëtarët e Këshillit Drejtues vlerësuan punën për hartimin e programit të trajnimit fillestar, metodologjinë e zbatuar gjatë procesit të hartimit, e veçanërisht përmbajtjen e programit e cila është harmonizuar me nevojat dhe kërkesat e gjyqtarëve të sapo emëruar. Duke e cilësuar kështu këtë program, si një avancim nga programi i mëhershëm, me një arsyeshmëri për secilën temë të hartuar dhe më kuptimplotë se ai i kaluari.

Gjatë këtij takimi, Këshilli Drejtues diskutoi dhe morri vendime edhe për çështje tjera që janë në kompetencë të punës së Këshillit, lidhur me funksionimin e Akademisë së Drejtësisë.





Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>